


# INSTITUTI EPIK

PRILL 2019

STATISTIKAT E AZILIT NË BASHKIMIN EVROPIAN



Ky studim përshkruan zhvillimet e fundit në lidhje me numrin e kërkesave të azilit në Bashkimin Evropian (BE).

Azili është formë e mbrojtjes ndërkombëtare e dhënë nga një shtet në territorin e tij. Azili i ofrohet një personi i cili nuk është në gjendje të kërkojë mbrojtje në vendin e tij/saj të shtetësisë dhe/ose vendbanimit, në veçanti për shkak të frikës nga persekutimi për shkaqe etnike, feje, kombësie, anëtarësie në një grup të caktuar shoqëror ose mendimi politik.

Studimi është i ndarë në pesë kapituj:

1. Kërkesat për azil në 28 Shtetet Anëtare të BE-së;
2. Top 30 vendet që kanë kërkuar azil në BE;
3. Kërkesat për azil nga Ballkani Perëndimor në BE;
4. Kërkesat për azil nga Kosova në BE;
5. Konteksti i politikave të azilit në Bashkimin Evropian.

Informacioni i paraqitur në këtë studim bazohet në të dhënat zyrtare të EUROSTAT-it

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



Ka pasur rritje graduale të numrit të kërkesave për azil brenda 27 Shteteve Anëtare të BE-së dhe më vonë të 28 Shteteve Anëtare të BE-së deri në vitin 2012, vit pas së cilit numri i azilkërkuesve u rrit me ritëm eksponencial, duke shënuar 431 mijë kërkesa në vitin 2013, 627 mijë në 2014 dhe rreth 1.3 milion në 2015 dhe 2016.

Në vitin 2018, 638 mijë azilkërkues aplikuan për mbrojtje ndërkombëtare në Shtetet Anëtare të BE-së. Kjo ishte 10% më pak se në vitin 2017 (712 mijë) dhe pak më shumë se gjysma e azilkërkuesve të regjistruar në vitin 2016, kur u regjistruan rreth 1.3 milion azilkërkues. Numri i azilkërkuesve në vitin 2018 është i krahasueshëm me nivelin e regjistruar në vitin 2014.

Sa i përket vendeve të Ballkanit Perëndimor, rekordi i azilkërkuesve u shënuar në vitin 2015 me një total prej 199,365 azilkërkuesve, prej të cilëve 172,225 ishin azilkërkues për herë të parë.

Në vitin 2018, trendi i rënies të numrit të azilkërkuesve ka vazhduar të bie, duke shënuar një rënie të re prej 10% krahasuar me vitin 2017, në të gjitha 28 Shtete Anëtare të BE-së

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin 2015, Kosova dhe Shqipëria ishin vende me numër më të madh të azilkërkuesve nga Ballkani me 72,480 dhe respektivisht 67,950 azilkërkues, prej tyre 66,885 dhe respektivisht 66,145 ishin azilkërkues për herë të parë.

Nga viti 2015, numri i azilkërkuesve nga Ballkani Perëndimor ka rënë në mënyrë të qëndrueshme në nivelin më të ulët të shënuar në vitin 2018 prej 40,420 azilkërkues, prej të cilëve 31,835 ishin azilkërkues për herë të parë. Në vitin 2018, Shqipëria dhe Serbia ishin vende me numër më të madh të azilkërkuesve nga Ballkani me 21,915, dhe respektivisht 6,145 azilkërkues, prej tyre 19,045 dhe respektivisht 4,340 ishin azilkërkues për herë të parë.

Në këtë drejtim, nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova ka shënuar rënie më të madhe të azilkërkuesve nga 72,480 në vitin 2015, prej të cilëve 66,885 ishin azilkërkues për herë të parë, në 4,970 në 2018, prej të cilëve 3,300 ishin azilkërkues për herë të parë - rënie prej 93%.

**Kosova shënoi rënie më të madhe të azilkërkuesve, nga 72,480 në vitin 2015, në 4,970 në 2018 – një rënie prej 93%**

# KËRKËSAT PËR AZIL NË 28 SHTETE ANËTARE TË BE-SË


Numri i azilkërkuesve të regjistruar për herë të parë në BE në vitin 2018 ishte 581 mijë, që është 57 mijë (9%) më pak se numri total i azilkërkuesve në vitin 2018.

Përkufizimi “azilkërkues i regjistruar për herë të parë” është një person që ka paraqitur kërkesë për azil për herë të parë në një Shtet Anëtar të BE-së. Prandaj, ky përkufizim nuk merr parasysh kërkesat e përsëritura për azil - gjë që siguron pasqyrim më të saktë të numrit të personave të ardhur për herë të parë në BE dhe cilët kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare brenda një shteti anëtarë të BE-së.

Të dhënat e fundit për numrin e azilkërkuesve në BE në vitin 2018, tregojnë rënie prej 74 mijë azilkërkuesve të regjistruar për herë të parë në BE, krahasuar me vitin 2017, pasi që numri i azilkërkuesve të regjistruar për herë të parë në BE ka rënë nga 655 mijë në vitin 2017 në 581 mijë në vitin 2018. Ky trend i rënies është në vazhdimësi të rënies dramatike prej 551 mijë nga viti 2016 në vitin 2017. Kontribuuesi kryesor në këtë trend të rënies është rënia e kërkesave për azil nga Siria dhe Nigeria.

Numri i azilkërkuesve të regjistruar për herë të parë në BE ka rënë nga 655 mijë në 2017 në 581 mijë në 2018

# KËRKËSAT PËR AZIL NË 28 SHTETE ANËTARE TË BE-SË



(\*) 2008 - 2014: Croatia not available.

(\*) 2008: Bulgaria, Greece, Spain, France, Croatia, Lithuania, Luxembourg, Hungary, Austria, Romania, Slovakia and Finland not available. 2009: Bulgaria, Greece, Spain, Croatia, Luxembourg, Hungary, Austria, Romania, Slovakia and Finland not available. 2010: Bulgaria, Greece, Croatia, Luxembourg, Hungary, Austria, Romania and Finland not available. 2011: Croatia, Hungary, Austria and Finland not available. 2012: Croatia, Hungary and Austria not available. 2013: Austria not available.

Source: Eurostat (online data code: migr\_asyappctza)

# TOP 30 VENDET QË KANË KËRKUAR AZIL NË BE

Azilkërkues nga Siria shënuan numrin më të madh të kërkesave për azil në Shtetet Anëtare të BE-së në 2018. Siria mban këtë pozicion çdo vit që nga viti 2013.

Në vitin 2018, numri i azilkërkuesve që kanë aplikuar për herë të parë në BE nga Siria ka rënë në 81 mijë nga 102 mijë sa ishte në vitin 2017, ndërsa pjesëmarrja e azilkërkuesve nga Siria në totalin e azilkërkuesve në 28 Shteteve Anëtare të BE-së ka rënë nga 15.6% në 13.9%. Siria ishte shtetësia kryesore e azilkërkuesve në tetë shtete anëtare të BE-së.

Afganët përbënin 7.1% të numrit total të azilkërkuesve që kanë aplikuar për herë të parë në BE, irakianët 6.8%, ndërsa pakistanezët dhe iranianët respektivisht 4.3% dhe 4.0%.

**Numri më i madh i  
azilkërkuesve që kanë  
aplikuar për herë të parë në  
BE vije nga: Siria, Afganistani  
dhe Iraku**

# TOP 30 VENDET QË KANË KËRKUAR AZIL NË BE

Sa i përket rritjes së numrit të azilkërkuesve që kanë aplikuar për herë të parë në BE në vitin 2018, rritje më të madhe relative në krahasim me vitin 2017 është shënuar për Venezuelën (rritje prej 1.8%), Gjeorgjia (rritje prej 1.6%), Turqia (rritje prej 1.5%), Iran (rritje prej 1.3%) dhe Kolumbia (rritje prej 1.1%).

Rënia më e madhe relative (përfshirë Sirinë) u shënuar për Nigerinë (rënie prej 2.2%) dhe Eritrea (rënie prej 1.2%).


**Rritje më e madhe relative të azilkërkuesve u shënuar nga Venezuela**

**Rënia më e madhe relative të azilkërkuesve u shënuar nga Nigeria**



# TOP 30 VENDET QË KANË KËRKUAR AZIL NË BE

## SHTETET E ORIGJINËS TË AZILKËRKUESEVE QË KANË APLIKUAR NË 28 SHTETE ANËTARE TË BE-SË



Source: Eurostat (online data code: migr\_asyappctza)

# TOP 30 VENDET QË KANË KËRKUAR AZIL NË BE

Me 162 mijë azilkërkues të regjistruar në vitin 2018, Gjermania përbënte 28% të të gjithë kërkesave për azil që janë bërë për herë të parë në shtetet anëtare të BE. Gjermania u pasua nga Franca (110 mijë ose 19%), Greqia (65 mijë, ose 11%), Spanja (53 mijë ose 9%), Italia (49 mijë, ose 8%) dhe Mbretëria e Bashkuar (37 mijë, ose 6%).

Sa i përket Shteteve Anëtare me më shumë se 5,000 kërkesa për azil që janë bërë për herë të parë në vitin 2018, shtetet ku u shënuar rritje më e madhe e numrit të kërkesave krahasuar me vitin 2017 ishin: Qipro (+70% azilkërkues, apo 3 mijë më shumë sesa në 2017), Spanja (+60% azilkërkues, apo 20 mijë më shumë), Belgjika (+29% azilkërkues, apo 4 mijë më shumë), Holanda (+27% azilkërkues, apo 4 mijë më shumë), Franca (+20% azilkërkues, apo 19 mijë më shumë) dhe Greqia (+14% azilkërkues, apo 8 mijë më shumë). Ndërsa, nga ana tjetër, rënia më e madhe relative u regjistrua në Itali (-61% azilkërkues apo 77 mijë më pak), Austri (-49% azilkërkues, apo 11 mijë më pak), Suedia (-19% azilkërkues, apo 4 mijë më pak) dhe Gjermania (-18% azilkërkues, apo 36 mijë më pak).


**Destinacionet kryesore:  
Gjermania, Franca dhe Greqia**

**Ngjitje më e madhe në Qipro,  
Spanjë dhe Belgjikë**

**Rënie më e madhe në Itali,  
Austri dhe Suedi**

# TOP 30 VENDET QË KANË KËRKUAR AZIL NË BE

## NUMRI I AZILKËRKUESVE NË SHTETET ANËTARE TË BE-SË DHE EFTA-SË



Source: Eurostat (online data code: migr\_asyappctza)

# KËRKESAT PËR AZIL NGA BALLKANI PERËNDIMOR NË BE



Viti 2015 shënoi rekordin e kërkesave për azil nga vendet e Ballkanit Perëndimor në BE. Janë parashtruar gjithsej 199.365 kërkesa për azil. Prej tyre 172,225 ishin azilkërkues që kanë aplikuar për herë të parë në BE. Kosova kryesoi në të dy kategoritë me 72,480 azilkërkues në total, nga të cilët 66,885 ishin azilkërkues për herë të parë. Shqipëria ishte e dyta me 67,950 azilkërkues, nga të cilët 66,145 ishin azilkërkues për herë të parë. Serbia ishte e treta me 30,065 azilkërkues, nga të cilët 19,095 ishin azilkërkues për herë të parë.


Që nga viti 2015, numri i azilkërkuesve ka rënë në mënyre dramatike në 40,420 azilkërkues të shënuar në vitin 2018. Prej tyre 31,835 ishin azilkërkues për herë të parë. Shqipëria udhëhoqi në të dy kategoritë me 21,915 azilkërkues, nga të cilët 19,045 ishin azilkërkues për herë të parë. Serbia ishte e dyta me 6,145 azilkërkues, nga të cilët 4,340 ishin azilkërkues për herë të parë. Kosova ishte e treta me 4,970 azilkërkues, nga të cilët 3,300 ishin azilkërkues për herë të parë. Kosova u pasua nga Maqedonia e Veriut me 4,655 azilkërkuesit, nga të cilët 3,285 ishin azilkërkues për herë të parë.

Viti 2015 shënoi rekordin e kërkesave për azil nga vendet e Ballkanit Perëndimor në BE. Janë parashtruar gjithsej 199.365 kërkesa për azil. Prej tyre 172,225 ishin azilkërkues që kanë aplikuar për herë të parë në BE

Që nga viti 2015, numri i azilkërkuesve ka rënë në mënyre dramatike në 40,420 azilkërkues të shënuar në vitin 2018. Prej tyre 31,835 ishin azilkërkues për herë të parë


# KËRKESAT PËR AZIL NGA BALLKANI PERËNDIMOR NË BE

Numri total i kërkesave të regjistruara  
të azilit




# KËRKESAT PËR AZIL NGA BALLKANI PERËNDIMOR NË BE

Kërkesat e azilit të regjistruara për  
herë të parë




# KËRKESAT PËR AZIL NGA SHQIPËRIA NË BE

Kërkesat e azilit të regjistruara për  
herë të parë



# KËRKESAT PËR AZIL NGA SERBIA NË BE


Kërkesat e azilit të regjistruara për  
herë të parë






# KËRKESAT PËR AZIL NGA MAQEDONIA E VERIUT NË BE

Kërkesat e azilit të regjistruara për  
herë të parë




# KËRKESAT PËR AZIL NGA BOSNJA DHE HERCEGOVINA NË BE

Kërkesat e azilit të regjistruara për  
herë të parë




# KËRKESAT PËR AZIL NGA MALI I ZI NË BE

Kërkesat e azilit të regjistruara për  
herë të parë



# KËRKESAT PËR AZIL NGA BALLKANI PERËNDIMOR NË BE (2018)

Kërkesat e azilit të regjistruara për herë të parë



# KËRKESAT PËR AZIL NGA KOSOVA NË BE




Në vitin 2015, Kosova përjetoi rritje drastike të azilkërkueseve në BE, me numrin total prej 72,480 azilkërkues, prej të cilëve 66,885 ishin azilkërkues për herë të parë.

Që nga atëherë, Kosova shënoi rënie më të madhe të azilkërkueseve, nga 72,480 në vitin 2015, në 4,970 në 2018 – një rënie prej 93%. Njëkohësisht, numri i azilkërkuesve për herë të parë ka rënë nga 66,885 në 2015 në 3,300 në 2018.

**Kosova shënoi rënie më të madhe të azilkërkueseve, nga 72,480 në vitin 2015, në 4,970 në 2018 – një rënie prej 93%**


# KËRKESAT PËR AZIL NGA KOSOVA NË BE

Numri total i kërkesave të regjistruara  
të azilit



# KËRKESAT PËR AZIL NGA KOSOVA NË BE

Kërkesat e azilit të regjistruara për  
herë të parë



# KONTEKSTI I POLITIKAVE TË AZILIT NË BASHKIMIN EVROPIAN

Konventa e Gjenevës e vitit 1951 në lidhje me statusin e refugjatëve (e ndryshuar me Protokol të Nju Jorkut të vitit 1967), për rreth 70 vjet, ka përcaktuar se kush është refugjat dhe ka përcaktuar një qasje të përbashkët ndaj refugjatëve, që ka qenë njëra prej gurthemeleve për zhvillimin e një sistemi të përbashkët të azilit brenda BE-së. Që nga viti 1999, BE ka punuar drejt krijimit të një regjimi të përbashkët Evropian të azilit, në përputhje me Konventën e Gjenevës dhe instrumentet e tjera të zbatueshme ndërkombëtare.

Programi i Hagës u miratua nga krerët e shteteve dhe qeverive më 5 nëntor 2004. Plani i politikave të Komisionit Evropian për azilin (COM (2008) 360 final) u prezantua në qershor 2008. Në vitin 2009, Komisioni Evropian bëri një propozim për krijimin e Zyrës Mbështetëse për Azil Evropian (EASO). Në maj 2010, Komisioni Evropian paraqiti një plan veprimi për të miturit e pashoqëruar (COM (2010) 213 final).

Janë zhvilluar një numër direktivash në këtë fushë. Katër instrumentet kryesore ligjore për azil - të cilat aktualisht janë subjekt i propozimeve për zëvendësimin ose rishikimin - janë:

1. Direktiva e Kualifikimit 2011/95/EU për standardet e kualifikimit të shtetasve jo të BE-së dhe personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status uniform për refugjatët ose për personat që gëzojnë të drejtën për mbrojtje plotësuese;
2. Direktiva e Procedurave 2013/32/EU për procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare;
3. Direktiva e Kushteve 2013/33/EU që përcakton standardet për pranimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare;



# KONTEKSTI I POLITIKAVE TË AZILIT NË BASHKIMIN EVROPIAN

4. Rregullorja e Dublinit (EU) 604/2013 për krijimin e kriterëve dhe mekanizmave për përcaktimin e shtetit anëtar të BE-së përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare të parashtruar në një nga Shtetet Anëtare nga një shtetas i një vendi të tretë (shtetas i një vendi jo-anëtar) ose person pa shtetësi.

Mbështetja operative dhe financiare e BE-së ka qenë kyçe për të ndihmuar Shtetet Anëtare në adresimin e sfidave të migrimit. Në veçanti, Komisioni Evropian u ofron Shteteve Anëtare mbështetje të vazhdueshme financiare nga Fondi për Azilin, Migrimin dhe Integrimin (AMIF). AMIF ka mbështetur në mënyrë efektive dhe të suksesshme reagimin e koordinuar BE-së ndaj krizës së migrimit.

Në prill të vitit 2016, Komisioni Evropian miratoi Komunikatën (COM (2016) 197 final) e cila lansoi procesin për një reformë të CEAS.

Kjo përfshinte opsione për një sistem të drejtë dhe të qëndrueshëm për shpërndarjen e azilkërkueseve midis Shteteve Anëtare të BE-së, një harmonizim të mëtejshëm të procedurave dhe standardeve të azilit për të krijuar një fushë të barabartë të lojës në të gjithë BE-në dhe në këtë mënyrë të zvogëlojë faktorët tërheqës që nxisin lëvizje të parregullta sekondare dhe forcimin e mandatit të EASO-së.

Në maj të vitit 2016, Komisioni Evropian paraqiti një paketë të parë reformash, duke përfshirë propozimet për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të drejtë të Dublinit (COM (2016) 270 final), duke përforcuar sistemin Eurodac (COM (2016) 272 final) dhe krijimin e një Agjencie Evropiane për Azilin (COM (2016) 271 final).

# KONTEKSTI I POLITIKAVE TË AZILIT NË BASHKIMIN EVROPIAN

Në korrik të vitit 2016, Komisioni Evropian paraqiti një grup të dytë propozimesh në lidhje me reformën e CEAS, ku mes tjerash synohet krijimi i një kornizë rivendosjeje për BE-në (COM (2016) 468 final) dhe një procedurë e përbashkët për mbrojtjen ndërkombëtare (COM (2016) 467 final) si dhe një rishikim të legjislacionit mbi standardet për pranimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare (COM (2016) 465 final).

Në mars të vitit 2019, Komisioni Evropian raportoi për përparimin e bërë gjatë 4 viteve të fundit dhe përcaktoi masat e nevojshme për të trajtuar sfidat e menjëhershme dhe të ardhshme të migrimit (COM / 2019/126 final).

INSTITUTI I KOSOVËS PËR POLITIKAT EVROPIANE, 2019.  
TE GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA.

